

VENDIM
Nr. 747, datë 23.9.2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 595, DATË 31.8.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT ‘NDËRTIMI DHE SISTEMIMI I RRUGËS ‘GYKATA – AKADEMIA E MARINËS’ + RRUGA ‘DURO SHASKA’ DERI TEK 7 PALLATET, VLORË, FAZA I”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 595, datë 31.8.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në pikat 3 dhe 4, vlera e përgjithshme e shpronësimit, për pasuritë e llojit “tokë truall” dhe “ndërtesë” nga 131 087 366 (njëqind e tridhjetë e një milionë e tetëdhjetë e shtatë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë, ndryshon dhe bëhet 134 790 025 (njëqind e tridhjetë e katër milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë mijë e njëzet e pesë) lekë.

2. Tabelës bashkëlidhur vendimit i shtohet tabela që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Shpenzimet procedurale në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

II. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Bashkia Vlorë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Lista e pronave shtesë që shpronësohen nga realizimi i projektit:
“Ndërtimi dhe sistemimi i Rrugës ‘Gjykata – Akademia e Marinës’ + Rruga ‘Duro Shaska’ deri tek 7 Pallatet, Vlorë, Faza I”

Nr.	ZK	Nr. i pasurisë	Adresa	Emri i pronarit	Lloji i pasurisë	Sip. që shpronësohet m ²	Çmimi i truallit lekë/m ²	Vlera e truallit lekë	Shënime
1	8602	36/175	Vlorë	Razie Shehu	Truall	239.6	10,903.00	2,612,358.80	Konfirmuar nga ASHK Vlorë
2	8602	36/117/6	Vlorë	Valentina Luari	Truall	100	10,903.00	1,090,300.00	Konfirmuar nga ASHK Vlorë
Shuma lekë								3,702,658.80	

Shënime: Për vlerësimin e pasurisë së llojit “tokë truall”, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.